



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2020:174964

Datë: 27.11.2023

Numri i dokumentit: 04977307

**P.nr.2550/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në lëndën penale të akuzuarit A. S. nga Fushë Kosova, i akuzuar për veprën penale Lëndim i lehtë trupor neni 185 par 2 lidhur me par 1 nën par 1.4 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.3984/2020 të datës 16.12.2020, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 15.11.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Besnik Jakupi, i dëmtuari A. F. dhe i akuzuari A. S., me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av. Shkodran Manaj, me datë 20.11.2023 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 27.11.2023 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari A. S., i biri i A. dhe nëna B., e gjinisë T. i lindur me ., në L. T., me vendbanim në F. K., rruga “E. P.”, me numër personal ..., të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i tete fëmijëve, e gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse:

Me datën 17.09.2020 rreth orës 22:40, në F. K., në rrugën “D.”, i pandehuri me dashje që ti shkaktojë lëndime trupore të dëmtuarit A. F. fillimisht debaton me fjalë me të duke i thënë “pse po qëndroni këtu dhe pse po bëni zhurmë”, “qe 20 vjet a”, e pasi që i dëmtuari i përgjigjet me fjalët “qysh ti ke ardhur që një javë këtu e ne jemi qe 20 vite këtu dhe po na thu shkoni brenda”, i pandehuri me një shkop të drurit, ngjyrë kafe dhe të gjatë rreth 1 metër e godet në kokë dhe fytyrë duke ia thyer një dhëmbë si dhe në pjesë të ndryshme të trupit me ç ‘rast i dëmtuari pëson lëndime trupore në formë të gërvishtjeve në dorën e djathtë dhe gishtin e dorës së majtë si dhe ka një dhëmb të thyer të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo të mprehtë),e që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

- *Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 nën par 1.4 te KPRK-së.*

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 46, 47,48, 69, 70, 71, 72 dhe 185 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarin e gjykon me:

### **DËNIM ME KUSHT**

- I.** Të akuzuarit A. S., për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 nën par 1.4 të KPRK-së, Gjykata i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënime nuk do të ekzekutohen nëse në periudhën verifikuese prej një (1) viti i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.
- II.** Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.
- III.** Gjykata në mbështetje të nenit 277 par.1 të KPPRK-së, nxjerrë këtë: URDHËR - URDHËROHET konfiskimi i përhershëm dhe atë: mjet-shkop druri, ngjyrë kafe rreth 1 metër.
- IV.** Pala e dëmtuar A. F., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet që ta realizon në procedurë të rregullt civilo-juridike.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.3984/2020 të datës 16.12.2020, ndaj të akuzuarit A. S. për shkak të dyshimit të bazuar mire se ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 nën par 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 15.11.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit Besnik Jakupi, i dëmtuari A. F., i akuzuari A. S., me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av. Shkodran Manaj, ku i akuzuari pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, e ka pranuar fajësinë për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 nën par 1.4 të KPRK-së, i kërkon falje palës së dëmtuar pasi ne kemi banuar ne një lagje dhe nuk kemi pasur probleme me të njëjtin, gjithashtu i premtonte Gjykatës që nuk do të përsëriten veprimet e tilla në të ardhmen.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. S., av. Shkodran Manaj, ka deklaruar se, jam konsultuar me te mbrojturin tim dhe i njëjti pranimin e fajësisë e bënë me vullnet të plotë dhe te pa ndikuar, prandaj konsideroj që pranimi i fajësisë i përmbush kushtet nga neni 242 i KPRK-së dhe ftoj gjykatën te njëjtën t'a pranoj si dhe njëkohësisht këtë rrethanë dhe rrethanat tjera plotësuese te cilat i përmendi i pandehuri të i merr si rrethana lehtësuese me rastin e shqyrtimit të dënimit, gjate konsultimit me te mbrojturin tim i njëjti shpreh keqardhje i kërkon falje të dëmtuarit dhe njëkohësisht zotohet se veprimet e tilla nuk do te përsëriten ne te ardhmen.

I dëmtuari lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar, e pranoj pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit dhe kërkim faljen e tij dhe njëkohësisht kërkoj kompensimin e demit i cili me është shkaktuar.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që një pranim i tillë bëhet në mënyrë vullnetare dhe se është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë si dhe ky pranim i fajësisë është në përputhje të plotë me provat dhe gjendjen faktike si ne aktakuzë.

Gjykata konstatoj se i akuzuari e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i akuzuari është e vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë për të cilat është njoftuar nga Gjykata, si dhe te gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 të KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarinimin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarinimit të akuzuarit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara si: Raporti fillestar i incidentit me numër 2020-AE-0921, i datës 17.09.2020; Raporti i policit K. H. #..., i datës 18.09.2020; Procesverbalin mbi marrjen në pyetje për të dëmtuarin A. F. i datës 17.09.2020 dhënë në Stacionin Policor në Fushë Kosovë; Procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin A. F., i datës 18.09.2020, dhënë në Stacionin Policor në Fushë Kosovë; Procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin E. H., i datës 18.09.2020, dhënë në Stacionin Policor në Fushë Kosovë; Procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin Sh. Ç., i datës 17.09.2020, dhënë në Stacionin Policor në Fushë Kosovë; Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dyshuarin A. S., i datës 17.09.2020 dhënë në Stacionin Policor në Fushë Kosovë; Akt ekspertimi mjeko-ligjor i Ekspertit Dr. F. B. i datës 20.10.2020; si foto dhe provat tjera që gjenden të bashkangjitura në lëndë, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, rrjedh se në veprimet e të akuzuarit A. S. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 nën par 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti më parë kishte sjellje korrekte dhe nuk kishte rënë asnjëherë ne konflikt me ligjin. Gjithashtu i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shprehur keqardhje për veprën që e ka kryer dhe kërkim faljen e tij. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarit. Ndërsa si rrethanë rënduese ishte fakti se i pandehuri ka kryer këtë vepër penale me dashje, prezenca e dhunës në këtë vepër penale.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim të nenit 48 të KPRK-se të akuzuarin e gjykoi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar te akuzuarit është ne përputhje me shkallen e përgjegjesisë penale te tij dhe me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura te shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do te shërbej për arritjen e qëllimit te dënimit ne pengimin e te pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne te ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do te ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë qe te përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 te KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 te KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 €uro.

Gjykata në kuptim të nenit 462 par. 2 të KPPRK-së, palën e dëmtuar e udhëzoi ne kontest civil për realizimin e kërkesës se saj pasurore juridike.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 361 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL**  
P.nr.2550/20 më datë 27.11.2023

**Bashkëpunëtori Profesional**

**Gjyqtarja e vetme Gjyquese**

**Albrim Kastrati**

**Laura Hoti Statovci**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.